

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: zgjedhjet parlamentare 2021

Rekomandime prioritare

Nr	Rekomandimi i OSBE /ODIHR	Statusi i implementimit	Komente dhe shënime të tjera
2	Shteti duhet të garantojë të drejtën për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo dhe si ka votuar duhet të parandalohet.	Progres i Pamjaftueshëm	Në Kodin Zgjedhor, të miratuar në Korrik dhe Tetor, 2020 janë bërë shtesa dhe ndryshime që lidhen me përmbajtjen e këtij rekomandimi të përsëritur edhe në raporte të mëparshme të vëzhguesve të OSBE/ODIHR. Pamjaftueshmëria e këtyre ndryshimeve kushtëzon nevojën për rregullime të mëtejshme në Kodin Zgjedhor dhe të ligjeve të tjera që trajtojnë çështje që lidhen me zgjedhjet si Ligji për partitë politike. Kodi Penal, ligjet organike të institucioneve ligjzbatuese.